



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerrë:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 01 / 2017 TATUARJA E PENSIONEVE ME RASTIN E TËHEQJES NGA FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS (FKPK)

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj detyrimet tatimore, mënyrën e deklarimit dhe pagesës së Tatimit në të Ardhurat Personale, për tatimpaguesit që përfitojnë të ardhura në emër të pensioneve me shumë të tërësishme, si dhe duke përfshirë atë në faza.

PËRKUFIZIMET

Për qëllimin e këtij Vendimi Shpjegues Publik, përkufizimet në vijim, kanë këtë kuptim:

FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës – një person juridik i themeluar sipas Ligjit për Pensionet me qëllim të sigurimit të kursimeve pensionale të rezidentëve të Kosovës, siç është përcaktuar më tej në KREU-n III të Ligjit për Pensionet.

Fond Plotësues – është shtyllë e tretë e sistemit pensional në Kosovë dhe gjithashtu është institucion i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Pension – është një pagesë e rregullt mujore për një pjesëmarrës (ose shfrytëzues) gjatë tërë jetës, duke filluar nga mosha e pensionimit, paaftësia fizike ose vdekja e pjesëmarrësit konform Ligjit Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale, Ligjit Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-101 dhe Ligjit Nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-115 dhe Ligjin nr. 04/l-168.

Pjesëmarrës – është person fizik në emër të cilit punëdhënësi ose pjesëmarrësi i paguan kontributet në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në çfarëdo fondi plotësues pensional të cilin e siguron punëdhënësi ose cildo siguroes i pensioneve i licencuar, sipas Ligjit Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale, Ligjit Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-101 dhe Ligjit Nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-115 dhe Ligjin nr. 04/l-168.

Përfitues – nënkupton një person fizik të cilin e ka caktuar pjesëmarrësi ose kur pjesëmarrësi nuk ka caktuar askënd apo nëse përfituesi i caktuar vdes para pjesëmarrësit, atëherë pjesëmarrësi e trashëgon atë, i cili ka fituar ose mund të fitojë të drejtën në mjete pensionale në bazë të të drejtave të pjesëmarrësit.

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës, njësi brenda Ministrisë së Financave, përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve pensionale në Kosovë. Si e autorizuar për mbledhjen e tyre cakton rregullat për funksionimin e këtij procesi.

I punësuar – është personi fizik i cili kryen punë kundrejt pagesës sipas urdhrit nën kontrollin e një punëdhënësi, pa marrë parasysh nëse puna është kryer në bazë të kontratës, ndonjë marrëveshje të formës tjetër qoftë me shkrim apo e pa shkruar. I punësuar përfshinë të gjithë zyrtarët publik dhe anëtarët e organit ekzekutiv, organet përfaqësuese dhe gjyqësore.

I vetëpunësuar – është çdo person fizik i cili punon për përfitim personal, me para të gatshme ose me mallra, i cili nuk përfshihet në përkufizimin e të punësuarit sipas Ligjit Nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Personale. Personi i vetëpunësuar e përfshinë ndërmarrjen afariste personale dhe ortakun e angazhuar në aktivitet ekonomik.

Punëdhënës – është çdo person apo etnitet që paguan paga përfshirë edhe: Autoritetin publik, Njësinë e përhershme të personit jo rezident, Organizatën jo-qeveritare, Organizatën ndërkombëtare përfshirë KFOR-in dhe EULE-in, me përjashtim të Kombeve të Bashkuara, Agjencitë e saj të specializuara dhe Agjencinë Ndërkombëtare për Energji Atomike.

EDI – është formë elektronike (on-line) e deklarimit / pagesës së tatimeve dhe kontributeve pensionale.

BAZA LIGJORE

Rregullore mbi pagesën e pensioneve individuale të kursyera:

Sipas Rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës, të miratuar më 15 Shtator 2016, mbi Pagesën e Pensioneve Individuale të Kursyera, Fondi dhe Ofruesi i Pensionit mund të krijojnë rregulla që të kryejnë pagesat e benifiteve të pensionit ndryshe nga blerja e kontratës së anuitetit në rastet kur:

- a. *Vlera në llogarinë individuale të pjesëmarrësit është 3,000 Euro ose më pak, Fondi dhe Ofruesit e pensioneve mund të paguajnë shumën totale.*
- b. *Vlera e kontributeve pensionale në llogarintë individuale të pjesëmarrësve është më e lartë se 3,000 Euro deri në 20,000 Euro, pjesëmarrësi gëzon të drejtën e tërheqjes përnjëherë 20% të shumës së mjeteve pensionale nga llogaria individuale, ndërsa pjesa e*

mbetur e mjeteve duhet të paguhet përmes programit të tërheqjes në faza të propozuar nga Fondi dhe ofruesit e pensioneve, i cili duhet të aprovohet nga BQK-ja.

- c.⁴ *Vlera në llogarinë e pjesëmarrësit është mbi 20,000 Euro, pjesëmarrësi gëzon të drejtën e tërheqjes përnjëherë 20% të shumës së mjeteve pensionale nga llogaria individuale, ndërsa pjesa e mbetur e mjeteve duhet të paguhet përmes programit të tërheqjes në faza të shprehur në përqindje e bilancit të llogarisë propozuar nga Fondi dhe Ofruesit e pensioneve, i cili duhet të aprovohet nga BQK-ja.*

Për pjesëmarrësit që kanë fituar statusin e invaliditetit para moshës së pensionimit, FKPK-ja duhet të bartë pjesërisht bilancin e kontributeve për pagesa fazore për atë kohë sa është përcaktuar invaliditetit nga komisioni përkatës.

Pagesat fazore për pensionin invalidor llogariten sipas programit të tërheqjes në faza të shumës minimale të propozuar nga Fondi dhe ofruesi i pensionit i cili aprovohet nga BQK-ja.

Pagesa mujore minimale nuk duhet të jetë më e vogël se pensioni bazë që paguhet në Republikën e Kosovës. Propozimi bëhet nga industria e pensioneve dhe aprovohet nga BQK-ja.

Pagesa e kontributeve bëhet në emër të përfituesit ose përfituesve të pjesëmarrësit, i cili ka vdekur para moshës së pensionimit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi, shuma e mjeteve pensionale nga llogaria individuale e pjesëmarrësit mund të transferohet në llogarinë individuale të përfituesit, nëse kështu zgjedh përfituesi. Shuma e mjeteve pensionale që është në llogarinë individuale gjithashtu, mund të paguhet në formë të dhënies së shumës së përgjithshme apo në formë të tërheqjes fazore sipas pikave a, b dhe c të këtij paragrafi, në rast se kështu zgjedh përfituesi.

Pjesëmarrësi që është duke pranuar pagesa fazore vdes para pranimit të vlerës që gjendet në Llogarinë Individuale, pagesat e mbetura fazore do t'i paguhet përfituesit/ve.

Ligji Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, Ligji Nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-101 dhe Ligji Nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/l-115 dhe Ligjin nr. 04/l-168:

Neni 1 Përkufizimet, citojmë:

“Administrata Tatimore e Kosovës - një njësi brenda Ministrisë së Financave, përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve pensionale në Kosovë”.

Neni 6, Mbledhja e kontributeve për financimin e pensioneve të kursimeve individuale, citojmë:

“Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të

punëdhënësit për punonjësit që kanë krijuar marrëdhënie pune dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit”.

Neni 12, Pagesa e kursimeve individuale pensionale, citojmë:

“Kur pjesëmarrësi arrin Moshën e Pensionimit, ai ose ajo do të bën blerjen e kursimeve pensionale në njërin nga format e Anuiteteve të caktuara në paragrafin 12.6 me të terën ose me një pjesë të shumës së Llogarisë Individuale të tij apo saj. BQK kohe pas kohe nxjerrë rregullore që specifikojnë minimumin e Kursimeve Pensionale që duhet të rezultojë nga blerja e një anuiteti”.

“.....Nëse pjesëmarrësi i cili nuk e ka blerë pensionin vjetor në pajtim me këtë nen vdes para moshës së pensionit, shuma në llogarinë e pjesëmarrësit i paguhet përfituesit apo shfrytëzuesve. PAGESA mund të bëhet në formë të dhënies së shumës së përgjithshme apo të transferit në llogarinë individuale të përfituesit. Personat që pretendojnë të jenë shfrytëzues kanë afat deri në gjashtë muaj pas vdekjes së pjesëmarrësit për t’ia dorëzuar kërkesat Fondit.....”

“.....Nëse pjesëmarrësi i cili nuk e ka blerë pensionin vjetor në pajtim me këtë nen vdes para moshës së pensionit, shuma në llogarinë e pjesëmarrësit i paguhet përfituesit apo shfrytëzuesve. PAGESA mund të bëhet në formë të dhënies së shumës së përgjithshme apo të transferit në llogarinë individuale të përfituesit. Personat që pretendojnë të jenë shfrytëzues kanë afat deri në gjashtë muaj pas vdekjes së pjesëmarrësit për t’ia dorëzuar kërkesat Fondit. Fondi mund të vendosë se përfituesi i cili është bashkëshort apo bashkëshorte ligjore ka të drejtë në llogarinë e plotë individuale dhe mund ta paguajë këtë shumë menjëherë pas marrjes së vendimit. Fondi vërteton gjendjen aktuale të shumës në llogarinë individuale të pjesëmarrësit në kohën e pagesës dhe dërgon cilëndo shumë për të cilën vendoset se duhet të paguhet pasi që të jetë bërë pagesa bazuar në barazimin vijues brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga cilado datë vijuese e raportimit kur vërtetohet se një shumë e caktuar pas barazimit duhet të paguhet.”

Neni 14, Fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit, citojmë:

“Punëdhënësit mund të sigurojnë pensione plotësuese të punëdhënësit nëpërmjet krijimit të fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësit (“fondet pensionale”). Fondet pensionale janë persona juridikë joprofitabilë, të krijuar në formë të fondeve për drejtimin e fondit pensional. Fondi pensional do të krijohet nëpërmjet një akti themelues të nënshkruar nga organi më i lartë qeverisës i punëdhënësit a i punëdhënësve për krijimin e fondit pensional sipas këtij ligji. Përmbajtja minimale e aktit themelues për krijimin e fondit pensional do të specifikohet në rregulloret që do t’i nxjerrë BQK-ja. BQK-ja e miraton përmbajtjen e çdo akti themelues. Mjetet pensionale të fondit pensional burojnë nga kontributet e bëra në llogari të pjesëmarrësve të fondit pensional dhe investimet e bëra me ato kontribute.”

Neni 21, Format e pensioneve plotësuese individuale, citojmë:

“Një person fizik mund të krijojë një pension plotësues individual për veten e tij duke bërë kontratë me një bankë të licencuar, me ndonjë instrument për investime të hapura ose me një tjetër institucion financiar për menaxhimin e një fondi të pensioneve me kontribute të caktuara, ose duke bërë kontratë me një kompani të licencuar sigurimesh për një pension të caktuar të beneficioneve. Të gjithë sigurvearit e pensioneve, p.sh. institucionet financiare, instrumentet për investime të hapura, bankat dhe kompanitë e sigurimit që sigurojnë pensione plotësuese individuale janë fiduciarë të pjesëmarrësve që blejnë pensione”.

Ligji Nr. 05/-028 për Tatim në të Ardhura Personale

Neni 7, paragrafi 1.7 parasheh që Pensionet e paguara nga një punëdhënës i përparshëm, apo në përputhje me Ligjin mbi Pensionet në Kosovë, do të përfshihen në të ardhura bruto, citojmë:
“Pensionet e paguara në përputhje me legjislacionin përkatës mbi Pensionet në Kosovë”.

Sipas Nenit 6, paragrafi 1 – Shkallët e Tatimit, citojmë:

“1. Tatimi në të ardhura personale vjetore, ngarkohet sipas shkallëve në vijim:

1.1 Për të ardhurat e tatueshme nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) ose më pak, zero për qind (0%);

1.2. Për të ardhurat e tatueshme mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €) deri në tremijë euro (3.000 €), duke përfshirë edhe shumën tremijë euro (3.000 €), katër për qind (4%) të shumës mbi nëntëqind e gjashtëdhjetë euro (960 €);

1.3. Për të ardhurat e tatueshme mbi tremijë euro (3.000 €), deri në pesëmijë e katërqind (5.400 €), duke përfshirë edhe shumën pesëmijë e katërqind (5,400 €), Tetëdhjetë e një pikë gjashtë euro (81.6 €) plus tetë për qind (8%) të shumës mbi tremijë euro (3.000 €); dhe

1.4. Për të ardhurat e tatueshme mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €), dyqind e shtatëdhjetë e tre pikë gjashtë euro (273.6 €) plus dhjetë për qind (10%) të shumës mbi pesëmijë e katërqind (5,400 €).”

Sipas Nenit 38, paragrafi 4 – Mbajtja e tatimit në Paga, citojmë:

“4. Pensionet e paguara nga apo për interes të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, apo nga një fond i autorizuar plotësues i pensioneve i rregulluar me legjislacionin përkatës mbi kontributet pensionale, si dhe sigurimet shëndetësore sipas Ligjit për Sigurimin Shëndetësor, i nënshtrohet mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve si dhe sigurimeve shëndetësore, të tilla në shkallët e parapara në nenin 6 të këtij ligji.”

Sipas Nenit 38, paragrafi 5 – Mbajtja e tatimit në Paga, citojmë:

“5. Secili punëdhënës, apo person që kërkohet të mbajë në burim sipas paragrafit 4 të këtij neni, dorëzon pasqyrën e tatimit të mbajtur në burim dhe e transferon shumën e tatimit të mbajtur në burim në llogarinë e caktuar nga ATK-ja në një bankë, apo institucion financiar, i licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor të lëshuar nga Ministri.”

E K
E FINA
MINOR



endr

MINISTRI
I
FINANCËS
DHE
TREGETISË
DHE
INDUSTRIËS

SHEMBUJ PËR ILUSTRIM

Mënyra përlogaritjes së Tatimeve sipas rasteve të shpërndarjes së pensioneve për tri kategoritë që ndërlidhen me rregulloren e re të BQK-së, të datës 15 Shtator 2016, mund të ilustrohen si në vijim:

1. Përfituesi ka të kursyera vlerën prej 2,900€ dhe Fondi / Ofruesi i pensioneve paguan shumën totale.

Të ardhurat e tatueshme	Baza tatimore	Norma Tatimore	Tatimi në të Ardhura Personale [€]
0 deri 960	960	0%	0.00
960 deri 2,900	1,940	4%	77.60
<i>Obligimi tatimor për periudhën</i>			77.60

2. Përfituesi ka të kursyera vlerën prej 19,000€ dhe Fondi / Ofruesi i pensioneve paguan shumën 20%, pra përfituesi pranon 3,800€.

Të ardhurat e tatueshme	Baza tatimore	Norma Tatimore	Tatimi në të Ardhura Personale [€]
0 deri 960	960	0%	0.00
960 deri 3,000	2,040	4%	81.60
3,000 deri 3,800	800	8%	64.00
<i>Obligimi tatimor për periudhën</i>			145.60

3. Përfituesi ka të kursyera vlerën prej 42,000€ dhe Fondi / Ofruesi i pensioneve paguan shumën 20%, pra përfituesi pranon 8,400€.

Të ardhurat e tatueshme	Baza tatimore	Norma Tatimore	Tatimi në të Ardhura Personale [€]
0 deri 960	960	0%	0.00
960 deri 3,000	2,040	4%	81.60
3,000 deri 5,400	2,400	8%	192.00
5,400 deri 8,400	3,000	10%	300.00
<i>Obligimi tatimor për periudhën</i>			573.60

4. Personi i cili ka të kursyera vlerën prej 22,000€, ka vdekur para se të arrijë moshën e pensionimit dhe Fondi / Ofruesi i pensioneve i paguan përfituesit shumën e tërësishme në vlerë prej 22,000€.

Të ardhurat e tatueshme	Baza tatimore	Norma Tatimore	Tatimi në të Ardhura Personale [€]
0 deri 960	960	0%	0.00
960 deri 3,000	2,040	4%	81.60
3,000 deri 5,400	2,400	8%	192.00
5,400 deri 22,000	16,600	10%	1,660.00
<i>Obligimi tatimor për periudhën</i>			1,933.60

PËRFUNDIM

Vlera e pensioneve të kursyera të cilat do të tërhiqen nga përfituesi si shuma të tërësishme, do të taten sipas shkallëve vjetore, siç janë paraparë me Ligjin Nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Personale. Po ashtu, shumat e tërësishme që do të përfitoj trashëguesi pas vdekjes së përfituesit i cili nuk ka arritur ende moshën e pensionimit, do të taten sipas shkallëve vjetore siç janë paraparë po me të njëjtin Ligj.

Ndërsa vlera e pensioneve të kursyera, të cilat do të tërhiqen nga përfituesi në faza të shprehur në përqindje sipas bilancit të llogarisë, propozuar nga Fondi apo Ofruesi i pensioneve, do të taten sipas shkallëve mujore siç janë paraparë me Ligjin Nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Personale..

HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Shpjegues Publik hynë në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së dhe i njëjti anulon Vendimin Shpjegues Publik nr. 06/2014 “Tatuarja e Pensioneve me rastin e tërheqjes nga FKPK” të datës 22.12.2014.

Datë: 11/04/2017

Prishtinë

Sakip Imeri

Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së

